## KËSHILLI ORGANIZATIV

1. Shukrije Statovci
2. Edip Sheji
3. Lefter Sinani
4. Ramadan Halimi
5. Nazife Sylejmani
6. Valbona Talifaj
7. Fejzullah Nebiu
8. Taulant Pengili

## KËSHILLI SHKENCOR

1. Vuksan Kola
2. Ferid Agani
3. Pasho Maksuti
4. Anila Hashorva
5. Jusuf Ulaj

## SEKRETARIA

1. Jeta Halili
2. Kaltrina Rama
3. Nusret Agani
4. Genti Hulaj
5. Rina Drevinja
6. Elbasan Ahmeti
7. Argita Saliaj
8. Dhurata Ejupi

Të nderuar anëtarë të Lidhjës së Psikiatrisë Shqiptare

Lidhja vazhdon rrugëtimin e saj, kësaj radhe në qytetin e Strugës aty ku edhe u themelua. Konferenca e dhjetë me temën "Psikiatria Psikosoamtike dhe e Konsultave "është vazhdimësi e punës dhe aktiviteteve të lidhjës që për një periudhë kohore janë penguar për shkak të pandemisë COVID-19.

Tema e përzgjedhur e konferencës është pjesë e punës tonë të përditëshme, është mjaft sfiduese dhe e vështirë për secilin prej nesh duke qenë se Psikiatria Konsultative- Liaison është një subspecialitet që e kemi të mangët, përkundër që hulumtimet e deritanishme e kanë identifikuar si "Roje e qasjës gjithëpërfshirëse ndaj pacientit".

Punimet që do të prezentohen në Konferencë janë përmbledhur në këtë libër abstraktesh dhe paraqesin të dhënat të reja të bazuara në evidencë, hulumtime dhe eksperienca profesionale do të na mundësojnë të shqyrtojmë dhe të diskutojmë çështje të rëndësishme nga të cilat do të përfitojmë ne dhe shfrytëzuesit e shërbimeve tona.

Ju dëshiroj punë të mbarë dhe të suksesshme.

Me respekt,

Shukrije Statovci, Kryetare e LPSH



**Prof. Asc. Afrim Dangëllia.** Lindur në 1950. 1967 – 1972 - Fakulteti i Mjekësisë-Universiteti i Tiranës. Psikiatër, Doktor i Shkencave, Profesor i Asocuar. Shërbimi Psikiatrik, QSU "Nënë Tereza"-Tiranë.

***Psikiatria Liaison* – " Blackbox i Psikiatrit "**

***A. Dangëllia.***

*-The liaison psychiatry staff assess and manage patients' mental health problems and use both medication and psychological therapy. The staff also work with patients' families and support other members of the multidisciplinary team to meet patients' emotional needs-*

- Hisorikisht psikiatria është ndeshur me shumë sfida gjatë gjithë kohrave që kurse u kristalizua si displinë e mjeksisë.

-Që në shek. tretë B.C. kishte filluar të njihej psikosomatika. Por ishte Johan Heinroth (1773-1843), ishte viti 1818 që ky autor përdori termin psikosoamtikë për herë të parë.

- Një tjetër psikiatër Amerikan James Putnam u cilësua si psikiatri i parë i konsultave në Spitalin e përgjithshëm të Massechusetts që në vitin 1872.

- Një tjetër psikiatre Amerikane Helen Dunbar botojë për herë të pare në 1936 një artikull në AJP ku citonte komorbiditetein e sëmundjes diabetike, sëmundjeve të zemrës dhe frakturave të kockave me Çreg. mendore.

- Por departamenti i parë i psikiatrisë Liaison u themelua në Spitalin e Colorados që në vitin 1934 nga psikiatri *Eduard Billings* ku dhe ai përdori për here të pare termin 'Liaison'

- Në vitin 1992 u propozua në USA që ***Psikiatria Liaison*** të ishte një nën specialitet më vete i psikiatrisë.

Shoqata mbretrore Britanike që në vitin 1953 nxori një ligj i cili citonte:

*1- Sëmundjet mendore dhe prapambetia mendore të vendoseshin në të njëjtin status sikurse sëmundjet patologjike.*

*2- Të hiqesh stigma e Spitaleve psikiatrike.*

*3- Të zgjerohesh së tepërmi shërbimi komunitar.*

- Mendohet se rreth 12% e mjekëve vizitojnë të sëmurë me ankesa somatike.
- Që të kuptojmë sa më mirë psikiatrinë e konsultave duhet të kemi parasysh *Mardhënien, Mind-body'*.
- Historikisht ndodhi që alienistët (Mjkët e  azileve) u mlodhën me academikët dhe vendosën që të krijohesh nje nënspecialitet si psikiatria Liasion?!
- UK mori një vendim te rëndësishëm që sëmundjet mendore të trajtoheshin një lloj si ato soamtike duke përfshirë dhe çështjet sociale që ato mbartin.

***Rast klinik*** !

- Sarah është një adoleshente 17 vjec Amerikane e cila ka rezultate mjaft të mira në mësime. Një ditë ajo pësoj nje Sincope (Të fiktë) kur mësuesja e ngriti në drasë të zezë. Kjo gjë ju përsërit Sarah disa herë. Prindërit e dërguan në disa mjekë për konsultime. Mjeku psikiatër konstatoj se Sarah  vuante nga *Çreg. Somatoform*.
- *Mjeket psikiater të konsultave bazohen tek boshti, **Boshti biofizik**' kur ata ndeshen me të sëmurët.*

U thye  bariera e ,,“ *Cartezianist Dualism*“ i R.Descarte (1596-1650 ), një kocpet mjaft i dëmshëm ky sepse përjashtonte psikiatrinë nga mjeksia e përgjithëshme. *Dhe psikiatria sot, është e inkuadruar brënda spitaleve të mjeksisë interne*.

*Ku bazohet psikiatria e konsultave (Liaison)* :

*1- Bazohet në studimin laboratorik dhe neuroimazherik të pacientit.*
*2- Bazohet në spiegimin e problemeve psikiatrike në mardhënie me fiziotherapinë.*
*3- Përdor terminologjinë mjeksore të zakonëshme.*
*4- Është familiare me mjeksinë e përgjithshme dhe me komorbiditet që ajo ndesh.*
*5- Ofron dije themelore dhe experiencë të pasur që bën të mundur komunikimin me kolegët e tjerë të medicinës. (Ali et al.2006)*



**Afrim AJRADINI**

I diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, ka punuar si mjek i përgjithshëm në QKMF-Prizren, tani mjek në specializim në Klinkën e Psikiatrisë, QKUK/SHSKUK. Nga Korriku i 1999 deri 2015 ka punuar në Organizata Ndërkombëtare.

**Simptomet somatike dhe mirëqenia tek pacientët në kujdesin primar**

A. Ajradini, S. Ajradini, F. Brina-Hashani, N. Fanaj

**Hyrje:** Në mjediset e kujdesit parësor, afërsisht 10% e pacientëve paraqesin ngarkesë të lartë ose shumë të lartë të simptomave somatike. Kjo padyshim ndikon edhe në mirëqenien e këtyre pacientëve.

**Qëllimi:** Njohja me prezencën e simptomave somatike dhe mirëqenien tek të sëmurët në kujdesin primar. Krahas saj kemi qëllimin sekondar që të njohim lidhjet mes tyre dhe variablave të tjerë si mosha, gjinia, prezenca e sëmundjeve kronike.

**Metodologjia:** Në një mostër kros-seksionale prej 76 pacientësh (51.3 % meshkuj dhe 48.7% femra, $M_{mosha}$=46.63, DS=15.19); të vizituar në ordinancën Private në Prizren janë aplikuar pyetësorët: Somatic Symptom Scale‒ 8 (SSS-8, Gierk et al, 2014) si dhe Ineksi i OBSH-së për Mirëqenien (WHO-5,1999). Përpunimi i rezultateve është bërë me SPSS 26 dhe Microsoft Excel 2016

**Rezultatet:** Sa i përket simptomeve somatike me nivel shumë të lartë kanë rezultuar 6 raste (7.9 %); me nivel të lartë 19 raste (25%); nivel mesatar 23 raste (30.3%) dhe me nivel të ultë 25 raste (32.9%). Mosha, gjinia, vendbanimi, shkollimi, punësimi, prezenca e Hipertensionit arterial, Diabetit, Sëmundjeve të zemrës dhe sëmundjeve kronike nuk kanë treguar korelacion sinjifikativë me nivelin e simptomave somatike, por kemi një korelacion sinjifikativë negativ në mes të simptomave somatike dhe nivelit të mirëqenies ($r=-.579$, $p<.00$). Prezenca e sëmundjeve kronike nuk tregon korelacion sinjifikativë as me nivelin e simptomave somatike dhe as me mirëqenien.

**Përfundimet:** Rreth dy të tretat epacientëve tregojnë nivel nga mesatarë deri shumë të lartë të simptomave somatike. Prezenca e simptomave somatike del të ket ndikim negativ në mirëqenien e pacientëve. Një skrinim më serioz imponohet në kujdesin primar për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve me simptoma somatike.

**Fjalët kyqe:** simptomat somatike, mirëqenia, kujdesi primar, sëmundjet kronike.

**Somatic symptoms and welfare of the patient's in primary health service**

A. Ajradini, S. Ajradini, F. Brina-Hashani, N. Fanaj

**Introduction:** Within the primary health care environment, around 10% of the patients are manifesting high burden or even higher somatic symptomatology. This fact is, undoubtedly, affecting patient's wellbeing.

**Aim:** Main aim of the study is recognizing of the presence of somatic symptoms and the well-being of the patients in primary health care. Additionally, our second goal is to know and understand the connections between them and other variables such as age, gender, the presence of chronic diseases.

**Methodology:** In a cross-sectional sample of the 76 patients' (51.3 % males, and 48.7% females, $M_{age}$=46.63, DS=15.19); visited in the Private practice in Prizren, we have applied questionnaires: Somatic Symptom Scale – 8 (SSS-8, Gierk et al, 2014) and Index of WHO for Well-being (WHO-5, 1999). Data processing has been done with the SPSS 26 and Microsoft Excel 2016

**Results:** In regards of the somatic symptoms, there were 6 cases with a very high level (7.9 %) ; with a high level 19 cases (25%); 23 cases with a average level (30.3%) and 25 cases with the low level (32.9%). Age, gender, place of residence, education, employment, presence of Arterial Hypertension, Diabetes, Heart disease and Chronic diseases didn't show significant correlation with the level of somatic symptoms, but we have a significant negative correlation between somatic symptoms and the level of well-being (r=-.579, p<.00). The presence of chronically diseases does not show any significant correlation neither with the level of somatic symptoms nor with well-being.

**Conclusions:** Approximately two-thirds of patients showed somatic symptoms starting from moderate to a very high level. The presence of somatic symptoms appears to have a negative

impact to the well-being of patients. A serious screening is imposed to be performed in primary care in the direction to identify, treat and refer cases with somatic symptoms.

**Key words:** somatic symptoms, welfare, primary health care, chronically diseases.

**Afërdita Goçi**

Është Specialiste e Psikiatrisë; punon në Psikiatri të fëmijëve - Klinikën e Psikiatrisë në QKUK, Prishtinë. Ka magjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë në vitin 2011 dhe është në përfundim të Doktoratës në lëminë e Psikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Ka publikime të shumta në revista shkencore ndëkombëtare. Aktualisht është e angazhuar në projektin hulumtues ndërkombëtar MIHRA që është projekt ku janë të përfshirë Universiteti i Baselit, Universiteti i Prishtinës, Muhimbili University of Health Allied Sciences nga Tanzania dhe Millennium Institute for Research in Depression and Personality nga Kili.

**Simptomat somatike te popullata civile e që ka përjetuar ngjarje traumatike gjatë luftës në Kosovë**

A, Goçi, A. Blyta, F. Agani, B. Hoxha, A. Ulaj, T. Haxhiu, S. Musliu, L. Shabani, S. Haxhibeqiri, D. Gashi

**Hyrje**: Ekspozimi ndaj përvojave traumatike në përgjithësi dhe sidomos zhvillimi i ÇSPT ka efekte negative jo vetëm në shëndetin mendor por edhe atë fizik të popullatës. Qëllimi i studimit tonë ka qenë hulumtimi i ndërveprimit të faktorëve gjenetikë dhe ambientalë në zhvillimin e ÇSPT, por edhe hulumtimi i komorbiditetit të këtij çrregullimi me probleme të tjera të shëndetit mendor dhe fizik.

**Metodologjia**: Mostra jonë përbëhet nga 166 pjesëmarrës, 90 meshkuj dhe 76 femra. Mosha e pjesëmarrësve në studim është 31-64 vjeç, mosha mesatare 44 vjeç. Pjesëmarrësit janë vlerësuar me pyetësorët përkatës në lidhje me ngjarjet e luftës: Life Stressor List; çrregullimin e stresit post traumatik: Clinician Administered PTSD Scale dhe simptomat somatike: Brief Symptom Inventory (BSI).

**Rezultatet:** Nga studimi ynë rezulton që individët që kanë zhvilluar çrregullim të stresit post traumatik kanë raportuar shkallë me të lartë të simptomave somatike. Korelacioni në mes të

ÇSPT dhe somatizimit është sinjifikant në nivel p = .01. Nuk kemi gjetë dallime sinjifikante gjinore sa i përket simptomatologjise somatike (p=.433), por kemi gjetë dallime sinjifikante në mes të grupeve në studim (p = 0.01), ku grupi me ÇSPT aktual ka raportuar në shkallë më të lartë simtptomave somatike, pasuar nga grupi që e kanë tejkaluar ÇSPT, ndërkohë që grupi kontroll ka raportuar më së paku simptoma somatike.

**Konkluzionet:** gjetjet nga studimi ynë janë në harmoni me ato të studimeve paraprake nga ku rezulton që personat e traumatizuar raportojnë shkallë më të lartë të problemeve somatike.

**Fjalët kyçe**: Çrregullimi Stresit Post Traumatik (ÇSPT), somatizimi, lufta, Life Stresor List (LSL), Clinician Administered PTSD Scale (CAPS), Brief Symptom Inventory (BSI).

**Somatic symptoms in civilian population who experienced traumatic events during the war in Kosova**

A, Goçi, A. Blyta, F. Agani, B. Hoxha, A. Ulaj, T. Haxhiu, S. Musliu, L. Shabani, S. Haxhibeqiri, D. Gashi

**Background**: Exposure to traumatic events and in particular development of PTSD have negative impact not only on mental health but also on physical health. The aim of our study was to assess the role of some environmental and genetic factors on development of PTSD and the comorbidity of this disorder with other mental health and physical problems.

**Methods**: Our sample consists of 166 participants, 90 males and 76 females. The age range of participants was 31-64 years, the mean age was 44 years. Participants were assessed with questionnaires such as: Life Stressor List for traumatic events experienced during the war; with Clinician Administered PTSD Scale for presence of PTSD and with Brief Symptom Inventory (BSI) for somatic symptoms.

**Results**: Results from our study show that individuals who have developed PTSD have reported higher level of somatic symptoms. Correlation between PTSD and somatization is significant at the p = .01 level. We did not find significant gender differences related to somatic symptoms (p=.433), but we found significant differences between groups in our study (p= 0.01) with current PTSD group reporting highest level of somatic symptoms, followed by remitted PTSD group. The control group reported much lower levels of somatic symptoms.

**Conclusions**: Findings from our study are in line with previous research showing that traumatized individuals report higher rates of somatic symptoms.

**Key words**: Post Traumatic Stress Disorder (PTSD), somatization, war, Life Stressor List (LSL), Clinician Administered PTSD Scale (CAPS), Brief Symptom Inventory (BSI).



**Arbër Zeka**

I diplomuar në Fakultetitn Filozofik dega Psikologji, Univerziteti i Prishtinës, më pas ka përfunaduar studimet master në Psikologji klinike dhe të shëndetit. Është psikolog klinik i licencuar dhe aktualisht punon si psikolog klinik në Drejtorinë e Burgjeve. Është autor dhe pjesëmarrës në konferenca dhe aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Puna terapeutike me shtypjen e çrregullimeve të brendshme dhe psikosomatike përmes psikoterapisë trupore**

A. Zeka, M. Sadiku, V. Ramaj, R. Xhema

**Abstrakt:** Shtypja e brendshme emocionale, e cila ndodh brenda individëve dhe grupeve të njerëzve që përjetojnë incidente traumatike, mund të kontribuojë në ankth, depresion, konfuzion të identitetit dhe ndjenja të inferioritetit, midis shqetësimeve të tjera të shëndetit mendor.
Ndërsa fusha e psikoterapisë trupore ofron modele trajtimi për të trajtuar ndikimin traumatik të shtypjes emocionale, me çrastë ka një hendek në të kuptuarit dhe adresimin e përvojës jetsore e cila lidhet me shtypjen e brendshme emocionale.

Kjo artikull do të eksplorojë, diskutojë dhe ofrojë ide se si ndërhyrjet e psikoterapisë trupore ndergjegjësojjn trupin, gjurmojnë ndjesit dhe burimet somatike për të adresuar shtypjen e brendshme dhe të mbështesim klientët në zhvillimin e kapaciteteteve për vete rregullim, dashuri për veten dhe fuqizimin për tu perballur me problemet e vazhdueshme me shtypjen emocinale. Rastet përdoren në arikull për të ilustruar këtë qasje klinike.

**Fjalët kyç:** *psikoterapia, psikoterapia trupore, somatica, rregullimi emocional, shtypja brendeshme e emocioneve.*

**Therapeutic work with the suppression of internal and psychosomatic disorders through body psychotherapy**

A. Zeka, M. Sadiku, V. Ramaj, R. Xhema

**Abstract:** Internalized emotional repression, which occurs within individuals and groups of people who experience traumatic incidents, can contribute to anxiety, depression, identity confusion, and feelings of inferiority, among other mental health concerns.

While the field of bodily psychotherapy offers treatment patterns to address the traumatic impact of emotional pressure, there is a gap in understanding and addressing the life experience associated with internal emotional pressure.

This article will explore, discuss and provide ideas on how body psychotherapy interventions can be aware of the body, trace somatic sensations and resources to address internal pressure, and support clients in developing the capacity for self-adjustment, love for self, and empowerment to face constant problems with emotional pressure. Cases are used in the article to illustrate this clinical approach.

**Keywords:** *Psychotherapy, Body Psychotherapy, Somatic, Emotional Adjustment, Internal Pressure of Emotions.*

***Tema*: *"Shkalla Manifestimit të Stresit, Ankthit, Depresionit dhe Djegies Profesionale në Raport me Reziliencën te Punëtorët e Kujdesit Shëndëtësor të Kosovës gjatë Periudhës së Pandemis Covid 19"***

B. Bojaxhiu Huçaj, S. Rexhepi.

***Objektivi:*** Pas një periudhe gati 2 vjeçare, vendi ynë vazhdon të ballafaqohet me Pandemin Covid - 19. Shërbimet mjekësore të domosdodhme për popullatën mbeten profesioni kyç që lidhë gamën e gjerë të shërbimeve dhe reagimin e parë në një situatë të krijuar si kjo. Ky studim ka për qëllim të vlerësoj ndikimin e pandemisë Covid -19 në nivelin e ankthit, stresit, depresionit dhe djegies të profesionistët shëndetësor dhe të përcaktojë marrëdhënien ndërmjet tyre me aftësit përballuese duke iu referuar zhvillimit të reziliencës. Të propozohen masat e duhura për mbështetjen e avansimit të shëndetit mendor të punëtorëve shëndetësor.

***Metodat:*** Studimi ka karakter kuantitativë, metodat ishin korelative dhe deskriptive. Për grumbullimin e të dhënave u përdor pyetësori DASS (Lovibond, S.H. & Lovibond, 1995) për stres, ankth dhe depresion, për të matur shkallën e djegies profesionale u përdor inventari MBI (Maslach 1996). Për të matur reziliencen u përdor pyetsori ARM-R (Ungar 2008,2011).

***Mostra:*** Respondenët që morën pjesë në këtë hulumtim ishin profesionistët e kujdesit shëndetësor nga QKUK, IKSHP, spitalet rajonale dhe QKMF -të nga Prishtina, Prizreni, Peja, Gilani, Ferizaji dhe Gjakova. Numri i pjesëmarrësve ishte 514 prej të cilëvë 376 femra dhe 137 meshkuj.

***Rezultatet:*** Vlerat mesatare të stresit ishin 13.20 me një devijim standard 11.70, për nivelin e akthit ishin 11.74 me devijim standard 10.91, për depresion 10.73 dhe devijimi standard 11.18. Djegia profesionale ishte mesatarishtë e lartë 40.54 me devijim standard 20.16 dhe niveli mjaftë i lartë i reziliencës 48.14 me një devijim standard 6.12.

***Konkluzione:*** Puna në vijën e parë në klinikat e Covid 19, lehtësisht ndikoi në mirëqenien e shëndetit mendor te punonjësit shëndetësor duke treguar pranin e nivelit të moderuar të ankthit, stresit dhe depresionit, ndërkaq shkalla e djegies ishte më shumë e pranishme te moshat e reja, që lë te kuptojm se me përvojën e punës shkalla e djegies bie, këtë na e kanë dëshmuar edhe rezulatet duke gjetur një korelacion negativ në mesë djegies dhe përvojës. Zhvillimi i lartë i faktorëve resilient bëri që ata të jenë shumë funksional gjatë punës së tyre.

**Fjalët kyqe**: *Stres, ankth, depresion, djegie, reziliencë, puntorë shëndetësor, Covid 19.*

***Topic: "Scale of Stress Manifestation, Anxiety, Depression and Professional Burning in Relation to Resilience of Kosovo Healthcare Workers during the Period of Covid 19 Pandemic"***

B. Bojaxhiu Huçaj, S. Rexhepi.

***Objective:*** After a period of almost 2 years, our country continues to face the Covid -19 Pandemic. Necessary medical services for the population remain the key profession that connects the wide range of services and the first reaction to a situation like this. This study aims to assess the impact of the Covid 19 pandemic on the level of anxiety, stress, depression and burnout of health professionals, and to determine the relationship between them and coping skills with reference to the development of resilience. To propose appropriate measures to support the mental health advancement of health workers.

***Methods:*** The study has a quantitative character; the methods were correlative and descriptive. The DASS questionnaire (Lovibond, S.H. & Lovibond, 1995) was used to collect data for stress, anxiety and depression. The MBI questionnaire (Maslach 1996) was used to measure the degree

of occupational burnout. The ARM-R questionnaire (Hungary 2008,2011) was used to measure resilience.

***Sample:*** Respondents who participated in this research were health care professionals from CUCK, NIPHK, regional hospitals and CCFM from Prishtina, Prizren, Peja, Gilan, Ferizaj and Gjakova. The number of participants was 514, of which 376 were females and 137 males.

***Results:*** The average value of stress is 13.20 with a standard deviation of 11.70, for the anxiety level the average value is 11.74 with a standard deviation of 10.91, for depression the average value is 10.73 and the standard deviation 11.18. Professional burnout was on an average of 40.54 with a standard deviation of 20.16, and a fairly high level of resilience of 48.14 with a standard deviation of 6.12.

***Conclusions:*** Front-line work in Covid-19 clinics, has easily affected the mental health well-being of health care workers by showing the presence of moderate levels of anxiety, stress and depression, while the burnout rate was more present to the younger age, which suggests that with work experience the rate of burnout decreases, which has been proven to us from the results, by finding a negative correlation between burnout and experience. The high development of resilient factors made them very functional during their work.

**Keywords:** *Stress, Anxiety, Depression, Burnout, Resilience, Health Workers, Covid 19.*



**Drita Gashi-Bytyqi**

Është Psikiatre për Fëmijë dhe Adoleshentë në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren. Ka mbaruar Edukimin Pasuniversitar për Psikoterapi Familjare dhe Edukimin Pasuniversitar të Supervizionit në Psikologji Klinike dhe Psikoterapi. Është anëtare e Shoqatës Botërore të Psikiatrisë, Shoqatës Evropiane të Psikiatrisë, Rrjetit Botëror të Psikiatërve të Rinj dhe Seksionit Botëror të Psikiatërve të Karrierës së Hershme. Autore dhe bashkëautore e shumë artikujve dhe punimeve shkencore. Pjesëmarrse aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Korniza konceptuale për zhvillimin, implementimin dhe vlerësimin e intervenimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë COVID-19**

D. Gashi-Bytyçi, R. Ransing, F. Adiukwu, V. Pereira-Sanchez, R. Ramalho, L. Orsolini, A. Luiz SchuhTeixeira, J. M. Gonzalez-Diaz, M. Pinto da Costa, J. Soler-Vidal, S. El Hayek, A. Larnaout, M. Shalbafan, Z. Syarif, M. Nofal, G. Kudva Kundadak;

**Hyrje:** Problemet e shëndetit mendor gjatë një pandemie janë të zakonshme, megjithëse vështirë për t'u trajtuar për shkak të kompleksitetit të pandemisë dhe mungesës së evidencës në lidhje me epidemiologjinë e problemeve të shëndetit mendor të lidhura me pandeminë dhe intervenimeve të mundshme për t'i trajtuar ato. Një kornizë e përshtatshme mund të ndihmojë në planifikimin, zhvillimin dhe ofrimin e kujdesit të shëndetit mendor gjatë pandemisë COVID-19 dhe pandemive të mundshme në të ardhmen.

**Qëllimi:** Si përgjigje, ne jemi përpjekur të zhvillojmë një kornizë konceptuale që mund të udhëzojë zhvillimin, implementimin dhe vlerësimin e intervenimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë COVID-19.

**Metodat**: U mblodh një panel i psikiatërve nga 16 vende të ndryshme. Opinionet e tyre u nxorën

nëpërmjet një pyetësori gjysmë të strukturuar. Ata u inkurajuan të japin pikëpamjet e tyre në lidhje me situatën aktuale të shëndetit mendor dhe burimet e mundshme në dispozicion. Atyre iu kërkua gjithashtu të propozonin zgjidhje dhe qasje për të ofruar kujdes të arritshëm dhe të përballueshëm. Korniza konceptuale u përgatit duke u bazuar në literaturën ekzistuese dhe pikëpamjet e shprehura.

**Konkluzionet**: Kjo kornizë konceptuale mund të shërbejë si një udhëzues teknik për studimet e ardhshme të shëndetit mendor të lidhura me pandeminë, mund të përdoret për të monitoruar tendencat dhe për të optimizuar përpjekjet në lidhje me shëndetin mendor, si dhe për të zhvilluar intervenime të shëndetit mendor të bazuara në evidencë. Megjithatë, ne supozojmë se nevojiten studime të mëtejshme eksploruese që fokusohen në komponentët individualë të kësaj kornize për të forcuar përgjigjen ndaj pandemive në nivel kombëtar dhe global.

**Fjalët kyçe**: COVID-19, Pandemi, Shëndet Mendor, Kornizë, Intervenim

## Conceptual framework for developing, implementing, and evaluating mental health interventions during COVID-19 pandemic

D. Gashi-Bytyçi, R. Ransing, F. Adiukwu, V. Pereira-Sanchez, R. Ramalho, L. Orsolini, A. Luiz SchuhTeixeira, J. M. Gonzalez-Diaz, M. Pinto da Costa, J. Soler-Vidal, S. El Hayek, A. Larnaout, M. Shalbafan, Z. Syarif, M. Nofal, G. Kudva Kundadak;

**Background**: Mental health problems during a pandemic are common, though difficult to address due to the complexities of pandemics and the scarcity of evidence about the epidemiology of pandemic related mental health problems and the potential interventions to tackle them. An appropriate framework can help plan, develop and deliver mental health care during COVID-19 and potential future pandemics.

**Aim**: As a response, we have attempted to develop a conceptual framework that could guide the development, implementation, and evaluation of mental health interventions during the COVID-19 pandemic.

**Methods**: A panel of psychiatrists from 16 different countries was convened. Their opinions were elicited via a semi-structured questionnaire. They were encouraged to provide their views about the current mental health situation and the possible resources available. They were also asked to propose solutions and approaches to provide accessible and affordable care. The

conceptual framework was prepared based on the extant literature and the views expressed.

**Conclusions**: This conceptual framework can serve as a technical guide for future pandemic related mental health research, could be used to monitor trends and to optimize mental health related efforts and to develop evidence based mental health interventions. We postulate however that further explorative studies focusing on the individual components of this framework are needed to strengthen the response to pandemics at both national and global level.

**Keywords**: COVID-19, Pandemic, Mental health, Framework, Interventions



**Ejona SHASKA (ZILJA),** Maj 2018 e në vazhdim Shefe e Shërbimit Akut pranë Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, Shtator 2012 –Maj 2018 nëndrejtore tenike pranë Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë. Dhjetor 2007- Shtator 2012 shefe e pavionit akut prane ketij spitali. Mjeke psikiatre që nga Marsi 2007. Pedagoge në Universitetin Publik "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Infermierise", që nga viti 2007 dhe në vazhdim, Pedagoge në Kolegjin Universitar Reald. Prej vitit 2014 antare e KMCAP Fier 2009-2015, KMCAP Vlorë 2015 e në vazhdim. Ka mbrojtur titullin "Doktor i shkencave" në vitin 2015. Ka marre pjese në shumë koferenca brenda dhe jashtë vendit dhe kam botuar artikuj në revista mjeksore.

**Çrregullimet depresive në komorbiditet me Morbus Parkinson**

E. Shaska (Zilja)

**Hyrje:** Morbus Parkinson është një sëmundje degjenerative me dëmtime të parikthyeshme që prek sistemin nervor, kryesisht neuronet që prodhojnë neurotransmetuesin dopaminë në një zonë specifike të trurit të quajtur substanca nigra Simptomat kryesore janë tremori, bradikinezia, rigiditeti. Sëmundja e Parkinsonit shpesh shoqërohet me simptoma të depresionit dhe ankthit. Çrregullimet depresive janë të zakonshme tek pacientët me sëmundjen e Parkinsonit dhe ndikojnë negativisht në shumë aspekte të tjera klinike të saj, jo vetëm në gjëndjen emocionale , por edhe në deficitet motore dhe njohëse, paaftësinë funksionale dhe cilësinë e jetës.

**Qëllimi** i këtij referati është të idendifikojë rëndësinë e Çrregullimeve depresive në Morbus Parkinson.

**Objektivat** Si ndikon fispatologjia e Morbus Parkinson në shfaqjen e Çrregullimeve depresive. Shënjat dhe simptomat, diagnostikimi i hershëm i depresionit, trajtimi dhe ecuria e tij në komorbiditet me Morbus Parkinson

**Metoda** Është përdorur një strategji studimi e rregullt, klinike tek një grua 75 vjeç, e cila është diagnostikuar fillimisht me Çrregullim depresiv dhe më vonë me Morbus Parkinson si dhe literaturë bashkëkohore mbi çrregullimet depresive në komorbiditet me Morbus Parkinson.

**Rezultatet** Çrregullimet depresive shpesh shfaqen 2 herë më shumë para Çrregullimeve të lëvizjeve(tremorit)ose M.Parkinson. Ato shoqërohen me humor të rënë,simptoma somatike, ndryshime konjitive dhe simptoma vegjetative.Çrregullimet depresive përgjithësisht trajtohen me antidepresivë SSRI ose SNRIs, anksiolitikë dhe Morbus Parkinson me karbidopa-levodopa.

**Konkluzion** Studimet tregojnë një prevalencë të lartë të çrregullimeve depresive në Morbus Parkinson të cilat shoqërohen me ashpërsi të sëmundjes, ulje të cilësisë së jetës, përkeqësim të funksionimit dhe kosto të lartë në mjekim.Trajtimi multidisiplinar është thelbësor për menaxhimin e sëmundjes dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

**Fjalët kyç**: Çrregullimet depresive, Morbus Parkinson, komorbiditet, trajtim

**Depressive Disorders in comorbidity with Morbus Parkinson**

E. Shaska (Zilja)

**Background:** Morbus Parkinson is a degenerative irreversible disease affecting the nervous system, mainly the neurons that produce the neurotransmitter dopamine in a specific area of the brain called substantia nigra. The main symptoms are tremors, bradykinesia, rigidity. Parkinson's disease is often associated with symptoms of depression and anxiety. Depressive disorders are common in patients with Parkinson's disease and influence many other clinical aspects of it, affect not only the emotional state but also impair motor and cognitive skills, functional ability, and quality of life.

**The aim** of this paper is to identify the role of depressive Disorders in Morbus Parkinson.

**Objectives:** How the pathophysiology of Morbus Parkinson impacts on the development of depressive disorders. Signs and symptoms, early diagnosis of depression, its treatment and progression in comorbidity with Morbus Parkinson

**Method:** A regular, clinical study approach has been tried on a 75-year old woman initially diagnosed with Depressive Disorder and later with Morbus Parkinson, as well as recent literature on depressive disorders in comorbidity with Morbus Parkinson.

**Results:** Depressive disorders often develop twice more than Movement Disorders (tremor) or M.Parkinson. They are characterized by low mood, somatic symptoms, cognitive changes and vegetative symptoms. Depressive disorders are generally treated with SSRI or SNRIs antidepressants, anxyolitics, while Morbus Parkinson with carbidopa-levodopa

**Conclusion:** The studies show a high prevalence of depressive disorders with Morbus Parkinson which is associated with disease severity; decrease of quality of life; high deterioration of functioning and increased cost of medical care. Multidisciplinary treatment is essential to manage the disease and improve the quality of life.

**Key words:** Depressive disorders, Morbus Parkinson, comorbidity, treatment;

## Rasti i një prezantimi jo të zakonshëm të Crregullimit Obsesiv-Kompulsiv te një adoleshente

E. Dashi, V. Skendi, V. Alikaj

**Hyrje:** Crregullimi Obsesiv Kompulsiv (OCD) është një nga crregullimet më të shpeshta (0.5%-4%) që prek fëmijët dhe adoleshentët dhe është konsideruar nga WHO si një nga 10 shkaqet që sjell paftësi globale. (1). Në shumicën e rasteve prezantimi i OCD është lehtësisht I dallueshëm, por shpesh te fëmijët dhe adoleshentët mund të ketë një prezantim atipik. Prezantimi atipik sjell keqdiagnostikim deri në mjekim të gabuar dhe efekte anësore serioze. (2)

**Metoda:** Ne prezantojmë rastin e një vajze 13-vjecare që fillimisht u keqdiagnostikua me psikozë cka solli fillimin e mjekimit me antipsikotikë. Në prezantimin e saj në urgjencë për shkak të natyrës së obsesioneve vajza sillej cuditshëm dhe nuk mund ta shpjegonte. Po ashtu vajza fillimisht e kishte të vështirë të diferenconte mendimet obsessive dhe i referonte si prani të "zërave urdhërues".

**Përfundimi:** Gjatë hospitalizimit, observimeve të gjata u arrit të kuptohej natyra e vërtet e simptomave të vajza, natyra e dhunshme e obsesioneve dhe prania e veprimeve compulsive që vajza i realizonte në fshehtësi nga frika e ndodhjes së një fatkeqësie. Ky rast na kujton të jemi të kujdesshëm dhe të kërkojmë për simptoma të mundshme të OCD te të rinjtë, sidomos në prezantimet në urgjencë ku koha është e kufizuar dhe mund të kemi keqdiagnostikim dhe keqtrajtim të pacientëve.

**Atypical Presentation of Obsessive-Compulsive Disorder in a Teenager; A Case Report**

E. Dashi, V. Skendi, V. Alikaj

**Introduction:** Obsessive-compulsive disorder (OCD) is one of the most prevalent psychiatric disorders (0.5% to 4.0%) affecting children and adolescents and is projected to be among the ten leading causes of global disability by the World Health Organization.(1) The phenomenology of OCD in children and adolescent is strikingly similar to that of adults. But at times, the presentation of OCD may be so atypical or unusual in children and adolescents that may lead to misdiagnosis or delay in diagnosis. (2).

**Method:** We report a case of 13-year-old girl who was initially misdiagnosed with psychosis, leading to the use of antipsychotic. In her emergency presentation because of the nature of the obsessions, the girl behaved strangely and could not explain her behaviour. The girl initially found it difficult to differentiate obsessive thoughts and referred to them as the presence of "orderly voices".

**Conclusions:** During hospitalization and long observations we understood the true nature of the girl's symptoms. We realized that in fact were intrusive, repetitive thoughts that order her to do compulsive actions. She always obeys to these thoughts as she was afraid that something bad will happen to her or her family. This case reminds us to be careful and look for possible OCD symptoms in young people, especially in emergency presentations where time is limited and we may have misdiagnosis and mistreatment of patients.



**Faton KUTLLOVCI**

I diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, aktualisht Drejtor i Klinikës së Psikiatrisë të Shërbimit Spitalor Klinik Univerzitar të Prishtinës, me gradën Doktor Shkence ligjërues në Universitetin "AAB ". Psikiatër në Poliklinikën "Shëndeti im" dhe Psikiatër konsultat në Spitalin Amerikan në Prishtinë.

**Psikiatria e konsultave -sfidat dhe perspektiva në të ardhmen në Kosovë**

*F. Kutllovci, N. Ibishi, T. Krasniqi*

Mendja dhe trupi janë të pandashëm; andaj ekziston lidhje e dyanshme mes psiqikës dhe somës, duke ndikuar në njëra tjetrën. Sëmundjet fizike shoqërohen me reakison psikologjik duke arritur në nivele morbide të sjelljes së crregulluar varësisht nga shkaktari biologjik. Gjithashtu është i njohur roli i përgjigjes neurokimike, imune dh endokrine ndaj stresit .

Ekziston një nevojë në rritje që psikiatria konsultative të bëhet pjesë integrale e menaxhimit të pacieniti në pothuajse të gjitha departamentet dhe klinikat mjekësore përfshirë këtu edhe vendin tonë, duka aplikuar casjen e orientuar te pacienti, e orientuar në krizë, në konsultë dhe casja e orientuar në situatë.

Nevoja për psikiatri konsultative mund të argumentohet edhe me faktin se në bazë të të dhënave nga studimet 20- 46% të pacientëve me sëmundje fizike të pranuar në repartet kirurgjike apo internistike kanë së paku një crregullim mendor koomorbid, dhe se frekuenca e crregullimeve mendore në këtë grup është substancialisht shumë më e lartë, se sa e popullatës së përgjithshme..

Bazuar në udhërrëfyesin e Shoqatës Evropiane të Psikiatrisë konsultuese dhe Akademisë së Mjekësis Psikosomatike, shumica e pacientëve në psikiatrin konsultuese hyjnë në njërën nga gjashtë grupet-kategori.

Casja në promovim të psikiatrisë konsultative përfshin subspecializimin në këtë profil, bashkëpunimi efektiv me lëmit tjera dhe shkëmbmi i njohurive për mes trajnimeve, diskutimet lidhur me shëndetin mendor duke promovu vlerat dhe reduku stigmën, si dhe hulumtimet shkencore në këtë fushë.

Aktualisht tek ne shërbimi i Psikiatrisë konsultative ofrohet në mënyrë ambulantore në konsultime që kryhen jashtë Klinikës si shërbim terciar si dhe në ambulanca specialistike, mirëpo rëndësia dhe kërkesat në rritje për shërbim konsultativ e shpreh nevojën e ngritjes në nivel të subspecializimit në vendin tonë si dhe perspektivës së hapjes së një reparti të veqantë ambulantor apo spitalor, për ofrimin e shërbimit terciar e gjithashtu të bëhet pjesë e ekipës multidisiplinare në të gjitha fushat e mjekësis- kirurgjike dhe jokirurgjike, duke marrë parasysh spektrin e gjërë të sëmundjeve organike, që shkaktojnë ndryshime të humorit dhe të sjelljes.

 **Gani HALILAJ**

Neuropsikiatër në IPFK/SHSKUK, më parë ka ushtruar funksione udhëheqëse në Ministri të Shëndetësisë/ Zyra për Shëndet mendor, është ish drejtor i IPFK. Ligjërues në UBT me thirrjen Profesor Asistent. Autor dhe pjesëmarrës në aktivitete profesionale shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

I diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, është mjek specialist Psikiatër në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, mbanë gradë shkencore Master në Menaxhment Shëndetësor dhe gradën e Doktorit të Shkencave në Psikologji. Èshtë ligjërues/pedagog në Kolegjin e Shkencave Mjekësore Rezonanca në Prishtinë me thirrjen e Profesorit të Asocuar. Èshtë autor i një varg punimesh shkencore dhe referues në mjaft tubime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Stigmatizimi i tè sèmurève mendor nè shèrbimet e tjera mjekèsore. Prezantim rasti**

R. Halimi, Q. Rexhepi, D. Isaku, S. Jashari-Ramadani;

**Hyrje:** Në mbarë botën, stigmatizimi personave me çrregullime mendore është problem i madh i cili ndikon negativisht edhe në cilësinë e jetës sè tyre. Në shumè vende tè botès çrregullimet mendore konsiderohen si njèri nga shkaktarèt kryesor tè paaftësisë. Sa më shumë të ndihen të stigmatizuar personat e sëmurë mendorë, aq më i ulët është vetëvlerësimi, përshtatja sociale dhe cilësia e jetës së tyre. Stigma gjithashtu ndikon në qasjen në kujdesin shèndetèsor, sepse njerëzit mund të ngurrojnë të kërkojnë ndihmë pavarësisht se përjetojnë probleme mendore dhe të tjera shèndtèsore, pasi kjo mund të shihet si një njohje e dobësisë ose dështimit. Prandaj, qëndrimet negative dhe stigmatizuese ndaj të sëmurëve mendorë kanë implikime të drejtpërdrejta në parandalimin, trajtimin, rehabilitimin dhe cilësinë e jetës së të prekurve. Nè jo rrallè raste, profesionisèt e fushave tè tjera mkekèsore, personat me çrregullime mendore i konsiderojnè apriori si të paparashikueshëm, të rrezikshëm, pa vetëkontroll dhe agresivë! Nè tè tilla raste stigma ndikon në gatishmërinë e profesionistit shëndetësor për të ofruar ndërhyrje të dobishme për individët me çrregullime mendore.

**Qèllimi:** tè pasqyrohen ecajaket tipike tè një pacienti me çrregullim mendor nè shèrbimet e tjera mjekèsore!

**Metoda:** Të gjitha të dhënat janë nxerrë nga dosja mjekësore e pacienit!

**Përfundimi:** Nga të dhënat rezulton se trajtimi i këtij pacienti psikiatrik në shërbimet e tjera është shoqëruara nga shmangia, neglizhimi dhe trajtimi jo adekuat!

**Fjalët kyqe:** stigma, çrregullim mendor, profesionist shëndetësor, shërbime të tjera.

**Stigmatization of mentally ill in other medical services. Case presentation**

R. Halimi, Q. Rexhepi, D. Isaku, S. Jashari-Ramadani;

**Introduction**: Worldwide, stigmatization of people with mental disorders is a major problem that adversely affects the quality of their lives. In many countries of the world, mental disorders are considered one of the main causes of disability. The more stigmatization mental persons feel, the lower the self-esteem, social adaptation, and the quality of their lives. Stigma also affects access to the health care, because people may be reluctant to seek help despite experiencing mental and other health problems, as this can be seen as a recognition of weakness or failure. Therefore, negative and stigmatizing attitudes towards mental patients have direct implications in the prevention, treatment, rehabilitation and quality of life of those affected. Quite often, for professionals of other health fields, people with mental disorder considered as unpredictable, dangerous, without self-control and aggressive! In such cases stigma affects the readiness of the health professional to provide useful interventions for individuals with mental disorders.

**Aim**: To reflect the typical vicissitudes of a patient with mental disorder in other medical services!

**Method**: All the data were extracted from the patient's health record!

**Conclusion**: The data show that the treatment of this patient in other medical services was accompanied by avoidance, neglect and inadequate treatment!

**Key words**: stigma, mental disorder, health professional, other services.

**Algoritmi i përditësuar i trajtimit të depresionit në praktikën klinike**

S. H Lala;

**Hyrje:** Efikasiteti i antidepresantëve ka qenë një temë e vazhdueshme debate, pavarësisht se gjatë dekadës së fundit, shumë barna antidepresivë janë hedhur në treg. Algoritmet psikofarmakologjike të mbështetura me prova klinike mund të thjeshtojnë procesin e zgjedhjes së medikamenteve duke lehtësuar vendimarrjet por dhe rezultatet për klinicistët.

Algoritmet e trajtimit në vetvete janë përshkrime disi më të detajuara dhe jo thjesht heuristikë apo udhëzime të zakonshme, por njëherit ato janë vendimarrje të dobishme për t'u përdorur në praktikën klinike. Nga pikëpamja klinike trajtimet farmako-terapeutike sipas algoritmeve përkatëse janë vendimarrje të përligjura dhe të matura që vlerësojnë barazpeshën ndërmjet rreziqeve dhe përfitimeve, duke i`u përmbajtur njërit nga parimeve bazë të mjekësisë: "së pari mos dëmto".

**Metoda:** Shkurtimisht, autori në këtë punim prezanton rezultatet e rishikimit të algoritmit bashkëkohor të trajtimit të episodeve depressive, bazuar në literaturën me focus kryesisht në provat e reja nga RCT (randomised control trial) RDoc si dhe udhëzimet, rishikimet dhe studime të tjera meta-analike bashkëkohore, veçanërisht në sugjerimet e PAPHSS si dhe shumë artikuj shkencorë me impakt faktor të lartë të publikuara në PubMed.

PAPHSS (Projekti i Algoritmeve të Psikofarmakologjisë në Harvard South Shore Program) është një projekt i një programi hulumtues shumë serioz në të cilin janë shoshitur në detaje të dhënat nga OHDSI. “Observational Health Data Sciences and Informatics” është një bashkëpunim ndërkombëtar i më shumë se 120 studiuesve nga 12 vende të ndryshme. Ky studim përfshin të dhënat mjekësore të 250 milionë pacientëve të trajtuar për depresion përkatësisht me antidepresantë të linjës së parë, të dytë dhe të tretë, nga mjekë të ndryshëm në këto vende.

Në këtë prezantim është paraqitur gjithashtu edhe një përmbledhje e shkurtër e disa rekomandimeve me vlerë përdorimi klinik mbi trajtimet më të fundit të miratuara nga FDA-ja për depresionin.

**Përfundime:** Nga të dhënat e shumë studimeve të mësipërme rezulton se vetëm njëmbëdhjetë përqind e pacientëve me depresion ishin trajtuar sipas një metodologjie unike.

P.sh. Olfson dhe kolegë, (2016) kanë konstatuar se: vetëm 28.7 për qind e 8.4 përqind të pacientëve me depresion kishin marrë trajtim dhe ky trajtim në 87 përqind të këtyre rasteve kish qenë vetëm

një antidepresiv. Trajtimi i bazuar në algoritëm ndihmon në përmirësimin e rezultateve klinike duke përshpejtuar remisionin dhe shmang kombinimet shpesh herë të panevojshme.
Algoritmet kanë potencialin të sigurojnë rezultate më një kosto efektivitet më të favorshëm, edhe kur rekomandohen opsione gjenerike (kur nuk ka disavantazhe të dukshme në rezultat ose siguri), përkundrejt kostos së produkteve "brand name".
Diagnostikimi dhe vlerësimi i saktë i episodit depresiv dhe komorbiditetit plus algoritmin përkatës të përditësuar, janë faktorë parashikues të një përgjigje sa të efektshme ndaj trajtimit.
**Fjalë Kyçe:** episod depresiv, algoritëm, rishikim, antidepresiv, OHDSI, PAPHSS, RCT, RDoc, meta analitik, FDA.



**Shqipe Alishani-Gorani**, e lindur në Prizren, studimet e mjekësisë së përgjithshme i ka kryer në Prishtinë, poashtu edhe specializimin nga Psikiatria. Pas përfundimit të specializimit e angazhuar në Ministrinë e Shëndetësisë në postin e Shefes së Resurseve Humane, kryetare e bordit për specializime dhe mbikëqyrëse e punës së bordit për regjistrim dhe licencim, bordit për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe bordit etik. Pjesëmarrëse në përpilimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative në kuadër të MSH. Pjesë e shumë projekteve ndërkombëtare. Pjesëmarrje në konferenca dhe kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare me prezantime punimesh. Nga viti 2013 me punë në Qendrën Klinike të Lozanes në Zvicër në postin e mjeke psikiatër-psikoterapeute. Formacionin për psikoterapi të kryer në Qendrën Klinike Universitare të Lozanës në aksin Terapia Kognitive Biheiviorale.

**Fibromialgjia shkaku apo pasoja e gjendjes psiqike**

Sh. Alishani-Gorani

**Objektivi** : Përpjekja për shpjegimin e lidhjes mes ankthit dhe depresionit që shpesh përcjellin pacientin e diagnostikuar me fibromialgji, të evitohet që pacientet të sillen nga një specialialist tek tjetri, të njihet si sëmundje dhe të mendohet rreth një protokolli të saktë të trajtimit.

Fibromialgjia është njohur si sëmundje nga OBSH që nga viti 1992, por fatkeqësisht natyra dhe ekzistenca e sëmundjes sot e kësaj dite është objekt diskutimi në botën e shëndetësisë.

**Metoda**: Është shqyrtuar literatura dhe data baza e fundit rreth fibromialgjise, hipotezat dhe rekomandimet e fundit, shembujt klinik dhe rezultatet e trajtimeve te ndryshme.

**Rezultati**: Udhëzimet praktike të diagnostikimit, trajtimit, të cilët mund te ndihmojnë në punën klinike të psikiatrit dhe psikologut në një sëmundje pak të njohur, shume diskutabile dhe e pa protokolle te standardizuara.

**Konkluzioni** : Ekzistojnë mendime kontradiktorë rreth etiologjisë, rreth termit shkak apo pasojë, mënyrës se trajtimit, konvencional apo alternativ. Mendime kontradiktorë për qasjen ndaj kësaj

« sëmundje te re » dhe domenit specialistik të cilit i përket. Të gjitha këto bëjnë zgjatjen e kohës se diagnostikimit dhe vonesës së trajtimit.

**Fibromyalgia - cause or consequence of a psychological state.**

Sh. Alishani Gorani

**Aim**: An attempt to explain the connection between anxiety and depression that often accompanies the patient that is diagnosed with fibromyalgia, to make sure that the patient doesn't go from one specialist to another, and to understand the disorder that is fibromyalgia in order to establish a correct treatment protocol.

Fibromyalgia is known as a disorder from the WHO (The World Health Organisation) since 1992, unfortunately the nature and existence of this condition is still undergoing intensive research and debate in the medical domain.

**Method**: Consists in consulting the latest literature and database on the topic of fibromyalgia, the hypothesis and recommendations, different clinical examples and the results of various forms of treatment.

**Results**: Achieving practical instructions of the diagnosis and treatment procedure, that should help in the clinical work of a psychiatrist or a psychologist for this little-known condition that doesn't yet have a standardized diagnostic or healing protocol.

**Conclusion**: There are many opposing opinions surrounding its etiology and whether fibromyalgia is a cause or a consequence of a psychological state. Many contradicting views still exist around the correct treatment of it - be it conventional or alternative. We still do not know to which domain of expertise the research on this disorder belongs. All of these factors contribute to the prolongation of the diagnostic and healing procedure.



**Shukrije Statovci** – Specialiste e Psikiatrisë, udhëheqëse e Departamentit të Çrregullimeve jopsikotike në Klinikën e Psikiatrisë të QKUK/ SHSKUK. Magjistër i Shkencave Mjekësore, edukim nga mjekësia mendje-trup në Qendrën Mendje trup, CMBM, Washington DC, dhe edukim në terapi familjare nga Akademia Amerikane e Terapisë Familjare, Universiteti i Illinoit, Çikago. Edukim Postdoctoral në Universitetin Illinois, Chicago.

Kryetare e Lidhjës së Psikiatrisë Shqiptare.

**Psikiatria konsultative-ndërlidhëse: Një hap drejt arritjes efektive të kujdesit psikiatrik për fushat e tjera mjekësore –shqyrtim literature**

Sh. Statovci

**Hyrje**: Psikiatria ndërlidhëse e njohur gjithashtu si Psikiatri konsultative ose Psikiatri konsultative lidhëse (CL) është degë e Psikiatrisë që specializohet në ndërlidhjen mes fushave tjera të mjekësisë dhe psikiatrisë, që zakonisht zhvillohet në një mjedis mjekësor dhe psikiatri ofron shërbim psikiatrik për pacientët me probleme tjera mjekësore. Përkundër rëndësisë, qëllimi dhe praktika e Psikiatrisë ndërlidhëse në shumë vende ende nuk njihet plotësisht. Psikiatrinë e

konsultave nuk e kemi të zhvilluar si subspecialitet në Kosovë përkundër që konsulta të tilla jemi të obliguar të realizojmë në praktikën tonë të përditëshme.

**Qëllimi**: Rishikimi aktual synon të nxjerrë në pah fushën e praktikës ndërdisiplinore psikiatrike dhe nevojën për të pasur shërbime efektive të ndërlidhjes klinike të psikiatrisë, me theks të veçantë në diskutimin e rolit, implikimeve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit efektiv psikiatrik në fusha të tjera të mjekësisë.

**Metoda**: Është bërë kërkim elektronik i literaturës për përzgjedhjen e punimeve të viteve të fundit në lidhje me temën e Psikiatrisë konsultative – lidhëse (CL) kryesisht në PubMed dhe Google Scholar.

**Rezultatet**: Nga studimet e përfshira në shqyrtimi del se shërbimet e ofruara të Psikiatrisë CL përmirësojnë rrjedhën e përgjithshme dhe prognozën e çrregullimeve të shëndetit fizik dhe mendor në pacientët e shtruar në spitale apo të trajtuar në mënyrë ambulantore nga profesionistë të fushave të tjera të mjekësisë.

**Konkludimi**: Njohja dhe zhvillimi i Psikiatrisë CL mund të ndihmojë në tejkalimin e barrierave ekzistuese të trajtimit të shëndetit mendor si njohja e dobët e problemeve të shëndetit mendor te pacientwt me swmundje tjera, trajtimi joadekuat dhe stigma e lidhur me sëmundjen.

**Consultative-liaison psychiatry: A step towards achieving effective psychiatric care for other medical fields - literature review**

Sh. Statovci

**Introduction**: Liaison psychiatry, also known as Consultative Psychiatry or Liaison Consultative Psychiatry, is a branch of psychiatry that specializes in the relationship between other fields of medicine and psychiatry, which usually takes place in a medical environment and psychiatry offers psychiatric services to patients with other medical problems. However, the purpose and practice of Psychiatry in many countries is still not fully understood. We have not developed Liaison psychiatry as a subspecialty in Kosovo, even we are obliged to carry out such consultations in our everyday work.

**Purpose**: The current review aims to highlight the field of interdisciplinary psychiatric practice and the need to have effective clinical liaison psychiatry services, ëith particular emphasis on

discussing the role, implications, and opportunities in providing effective psychiatric care in other areas of medicine.

**Methods:** An electronic literature search was made for the selection of works of recent years related to the topic of Consultative Liaison Psychiatry (CL) mainly in PubMed and Google Scholar.

**Results:** From the studies included in the review, it appears that the services provided by CL Psychiatry improve the overall course and prognosis of physical and mental health disorders in patients hospitalized or treated on an outpatient basis by professionals from other fields of medicine.

**Conclusion:** Recognition and development of CL Psychiatry can help overcome existing barriers to mental health treatment such as poor recognition of mental health problems in patients with other illnesses, inadequate treatment and stigma associated with the disease.



**Prof. dr. sci. Sylen S. Vranica** u lind në Prizren ku e kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, specializon në lëminë e neuropsikiatrisë në Zagreb ku edhe magjistron në sferën neurologjike. Në vitin 1987 e mbron tezën e doktoratës në Prishtinë. Në vitin 2001 zgjedhet profesor ordinar. Ka qenë shef i katedrës së neuropsikiatrisë, drejtor i klinikës neurologjike, shef për studime postdiplomike nga lëmia e neurologjisë dhe psikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ligjërues i studimeve postdiplomike në Fakultetin e psikologjisë në Tetovë, organizator i dy simpoziumeve neurologjike me karakter ndërkombëtar, mentor dhe koomentor i afro 30 temave të magjistraturës dhe tezave të doktoratës, autor dhe koautor i mbi 90 punimeve profesionalo-shkencore, kryetar dhe anëtar i komisioneve postdiplomike nga lëmia e neurologjisë dhe psikiatrisë, anëtar dhe kryetar i komisionit për kuadro dhe zhvillim në fakultetin e mjekësisënë Prishtinë.

**Psikiatria psikosomatike dhe konsultative, me theks në paraqitjen tek pacientët epileptikë**

S. Vranica, P. Vranica, L. Vranica

**Qëllimi:** është të paraqitet aspekti psikosomatik dhe konsultativ tek pacientët epileptikë.

**Materiali dhe metoda e punës:** është paraqitur rasti i pacientes epileptike me çrregullime të shumta psikosomatike

**Rezultati**: tek pacientja, përveç trajtimit medikamentoz antiepileptik, është përdorur edhe metoda konsultative dhe këshilluese në trajtimin dhe mbarëvajtjen e mëtutjeshme të sëmundjes.

**Diskutimi:** Psikosomatika është shkencë që përfshinë dukuritë biologjike, medicinale, psikologjike, fiziologjike dhe sociologjike. Konsultimi psikiatrik në psikiatrinë psikosomatike ka të bëjë me problemet e sjelljes, të problemeve psiqike dhe çrregullimet e ndryshme shëndetësore dhe të përshtatjes me sëmundjen. Çrregullimi psikosomatik bënë fjalë për bashkësinë e ndërsjellë në mes të trupit dhe gjendjes psiqike si edhe me ndikimet e tyre të ndërsjella, përkatësisht, me ndikimet psikologjike në gjendjen somatike. Epilepsia është sëmundje neurologjike me mjaft çrregullime psiqike siq janë stresi, ankthi, ankioziteti, problemet me gjumin etj. Stresi paraqitet me intenzitet më të lartë në epilepsinë e pakontrolluar ndërsa është më i ulët në epilepsinë e

kontrolluar mirë. Faktorët psikosomatikë ndikojnë drejtpërdrejt ose indirekt mbi stresin nëpërmjet kontrollit të sulmeve epileptike. Menaxhimi i mirëfilltë i faktorëve psikosomatikë mund të parandalojë krizat e mëtejshme. Sipas teorisë psikosomatike, epilepsia është konflikt i brendshëm i personalitetit, një lloj i protestit kundër dhunës, konflikt ndaj botës së jashtme, që më shpesh lajmërohet tek personat me mllef apo kundërshtim, ndaj duke e ndrydhur dhe kamufluar këtë gjendje, përjetojnë çrregullime të ndryshme psikosomatike.

**Përfundim:** Në punim është paraqitur rasti i vajzës, KL, 25 vjeçare, e cila shpesh përjeton sulme kur ka të bëjë të takohet me të dashurin, me të cilin mendon të martohet por nuk ka guxim t'ja pranon propozimin e tij për martesë, pasi që ai ende nuk është njohur me natyrën e sëmundjes së saj?! Poashtu, përjeton sulme kur mendon të takohet me shoqet për ndonjë zbavitje të përbashkët! Tek rasti në fjalë, përveq trerapisë medikamentoze antiepileptike, u desh mjaft kohë për trajtim nga sfera psiqike. Psikosomatika i ndihmon pacientit që në mënyrë të shëndoshë dhe të logjikshnme të ketë pikëpamje ndaj gjendjes dhe jetës së vet. Nëse ndryshon këtë pikëpamje mund t'i ndihmon vetes në reduktimin e sulmeve epileptike duke iu përmbajtur këshillave. Psikosomatika ndihmon në gjetjen e shkaktarëve të sëmundjes epileptike, në konsultim edhe me ekspertët që merren me çrregullimet psikosomatike.

**Rekomandim:** Pothuajse në çdo sëmundje apo çrregullim shëndetësor nëse lajmërohet prezenca e simptomave psikosomatik, përveç trajtimit medikamentoz, indikohet edhe trajtimi multidisciplinar nga sfera psikosomatike.

**Summary:** In almost every disease or health disorder, if the presence of psychosomatic symptoms is reported, in addition to drug treatment, multidisciplinary treatment from the psychosomatic sphere is also indicated.



**Valbona ALIKAJ**

E diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës më 1992, mjeke specialiste e Psikiatrisë, mban gradët shkencore Master dhe Doktore e Shkencave, shtë ligjëruese në lëndët Psikologji Mjekësore dhe Psikiatri në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë me thirrjen Profesor i Asocuar. Është autore e një varg punimesh shkencore dhe referuese në shumë aktivitete profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Impakti i pandemisë COVID-19 në shëndetin mendor dhe ngarkesën emocionale. Studim i zhvilluar ne Iran, Indi, Shqipëri dhe Nigeri**

V. Alikaj, E. Dashi, V. Skendi

**Hyrje:** Pas shfaqjes se coronavirus (COVID-19) rritja e informacionit negativ dhe tensionimit te popullatës mbarëbotërore ka sjellë ndikimin masiv në shëndetin mendor në botë. Eshtë mëse e dukshme që në rastet e infektuara apo dyshuara me COVID-19 përvec simptomave fizike kemi prani të një ngarkese psikoemocionale dhe të problemeve të tjera shëndetësore. Efektet direkte dhe indirekte sociale dhe psikologjike të pandemisë coronavirus (COVID-19) janë pervazive dhe mund të prekin shëndetin mendor të individit në të tashmen dhe në të ardhmen. (Holmes et al., 2020) (Li et al., 2020).

**Qëllimi**: Qëllimi kryesor i studimit tonë ishte të hetonim mbi prevalencën e problemeve të shëndetit mendor të lidhura me COVID-19 dhe problemet e zakonshme të shëndetit mendor në popullaten e përgjithshme në katër shtete (Indi, Iran, Nigeri dhe Shqipëri).

**Metoda:** U realizua një pyetësor online cross-sectional duke përdorur google form në 4 shtetet, në gjuhën zyrtare. Ne përdorëm pyetje demografike dhe pyetësor për depresionin, ankthin, frikën, pagjumësine, frikën nga coronavirus, ankthin nga coronavirus.

**Rezultatet:** Në analizën finale u përfshinë 1787 pjesmarrës (përjashtuan duplikatat 43, 98 refuzuan dhe 23 ishin pyetësor jo të përfunduar). Prevalenca e problemeve të shëndetit mendor ishte më e lartë në popullatën Iraniane në krahasim me popullatat e tjera. Frika, depresioni, ankthi dhe mosha ishin variabla të rëndsishëm për ankthin ndaj coronavirusit.

**Konkluzione:** Vëmendja dhe ndërhyrja emergjente ndaj problemeve të shëndetit mendor gjatë një pandemie është e zakonshme, ndonëse e vështirë për tu adresuar si për shkak të kompleksitetit të vet pandemisë dhe për mungesën e të dhënave për epidemiologjinë e problemeve të shëndetit mendor të lidhura me të dhe të ndërhyrjeve të nevojshme për të trajtuar.

**Mental health issues during COVID-19 pandemic in Iran, India, Albania, and Nigeria**

V. Alikaj, E. Dashi, V. Skendi

**Introduction:** In the last months, after the outbreak of a new coronavirus infection (COVID-19) on 31 December 2019 among humans in Wuhan (China), an increasing amount of information and concerns are impacting global mental health. It is already evident that apart from physical suffering, in confirmed or suspected cases of COVID-19 suffering from great psychological pressure and other health-related problems. The direct and indirect psychological and social effects of the coronavirus disease 2019 (COVID-19) pandemic are pervasive and could affect mental health now and in the future. (Holmes et al., 2020) (Li et al., 2020).

**Objectives:** The central aim of our study was to investigate the prevalence of COVID-19 related mental health issues and common mental health issues among the general population across four countries (India, Iran, Nigeria, and Albania).

**Method:** A Cross-sectional online survey was done using google form and multi-centered international study across countries. We used demographic questions and scales for depression, anxiety, insomnia, coronavirus fear, coronavirus anxiety, and fear.

**Results:** A total of 1787 participants were included in the final analysis (excluding duplicates = 43, non-response=98 and incomplete response =23). The prevalence of mental health issues was higher among the Iranian population than others. The fear, depression, anxiety, and age were significant but variable determinants of coronavirus anxiety.

**Conclusions:** The emergence of mental health (MH) problems during a pandemic is extremely common, though difficult to address due to the complexities of pandemics and the scarcity of evidence about the epidemiology of pandemic related MH problems and the potential interventions to tackle them.

 **Valbona Tafilaj**

E diplomuar në vitin 2007 në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. E specializuar në Psikiatri, aktualisht punon në Klinikën e Psikiatrisë/ QKUK.

È̀shtë kryesuese e komisionit të ankesave të të burgosurve për trajtimin shëndetësor në burgje të Kosovës, si dhe është Anëtare dhe Arkatare e bordit drejtues të Lidhjes së Psikiatrisë Shqiptare dhe anëtare e Asociacionit të Psikiatrave të Kosovës.

**Bashkëpunimi në mes të Klinikës së Psikiatrisë dhe Klinikës së Endokrinologjisë**

V. Tafilaj, Psikiatër

**Hyrje:** Hulumtimet në psikiatri e kanë identifikuar Psikiatrinë Konsultative-Liaison si shumë të rëndësishme, duke nënvizuar rolin e saj kryesor në menaxhimin e pacientëve që shtrohen në spital për probleme të ndryshmë mjekësore. Në të gjithë mjekësinë kuptohet se tiparet psiko-sociale ndikojnë në etiopatogjenezën dhe prognozën e shumë sëmundjeve kronike përfshirë këtu edhe ato endokrinologjike

**Qëllimi**: Hulumtimi është fokusuar në dokumentimin e ofrimit të rasteve psikiatrike te pacientët me probleme endokrinologjike. Gjithashtu punimi ka për qëllim të identifikojë faktorët që ndikojnë në realizimin e ofrimit të këtyre shërbimeve.

**Metodat**: Për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar të dhënat e gjashtë muajve të fundit nga librat e protokolit në të cilat dokumentohet për cilat diagnoza është kërkuar konsulta, mosha dhe gjinia e pacientëve dhe vendi prej nga ata vinë.

**Konkludimi:** Rezultatet e hulumtimit do të na shërbejnë për të kuptuarit e specifikave të kërkesave të Psikiatrisë së konsultave-liaison në Klinikën e Endokrinologjisë.

**Cooperation between the Clinic of Psychiatry and the Clinic of Endocrinology**

V. Tafilaj, J. Halili.

**Introduction**: Research in psychiatry has identified Consultative Psychiatry-Liaison as very important, underlining its key role in the management of patients who are hospitalized for various medical problems. Throughout medicine, it is understood that psycho-social features influence the etiopathogenesis and prognosis of many chronic diseases, including endocrinological ones.

**Purpose**: The research is focused on documenting the provision of psychiatric cases to patients with endocrinological problems. Also, the paper aims to identify the factors that influence the provision of these services.

**Method**: For the realization of this work, the data of the last six months from the protocol books were used, in which it is documented for which diagnosis the consultation was requested, the age and gender of the patients and the country from which they come.

**Conclusion**: The results of the research will serve us to understand the specific requirements of Psychiatry consultation-liaison in the Clinic of Endocrinology.



**Valdete Alidema-Serreqi**

Psikiatër në Klinikën e Psikiatrisë në repartin e sëmundjeve psikotike. E diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajeve. Edukim në terapi Familjare nga Akademia Amerikane terapisë familjare, univerziteti I Ilinoit Cikago SHBA. Ish drejtoreshë e Klinikës së Psikiatrisë, Ligjëruse në UBT Fakultein e Stomatologjisë dhe Infermierisë. Kryetare e Asociacionit të Psikatrave të Kosovës.

**Konsultat Psikiatrike nga Klinika e Psikiatrisë për fushat tjera të mjekësisë.**

V. Serreqi, Sh. Statovci, F. Kutllovci, J. Halili.

**Hyrja:** Psikiatria e konsultave është fushë e Psikiatrisë në të cilën roli i psikiatrit konsultativ-ndërlidhës është të shohë pacientët me gjendje mjekësore komorbide me kërkesë të konsulentit ose ekipit mjekues që trajton pacientin. Përkundër që Psikiatria e Konsultave Liaison nuk është e zhvilluar në Kosovë dhe ne nuk kemi specifikisht Psikiatër konsultativ-ndërlidhës Klinika Psikatrike realizon konsulta për Klinika të fushave të tjera mjelësore.

**Qëllimi:** Hulumtimi ka për qëllim të dokumentojë cilat janë klinikat që kanë kërkuar konsulta nga psikiatri për pacientët me probleme nga fushat tjera të mjekësisë dhe cili ka qenë numri i këtyre konsultave.

**Metodat**: Për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar të dhënat nga librat e protokolit të gjashtë muajve të fundit në të cilat dokumentohet konsultat që relaizohen nga Klinika e Psikiatrisë për Klinikat në fushat tjera të Mjekësisë.

**Konkludimi:** Rezultatet e hulumtimit do të na shërbejnë për të kuptuarit e specifikave të kërkesave të Psikiatrisë së konsultave-liaison nga klinikat tjera si dhe do të shërbejnë si nxitje për lobimin e fuqizimit të subspecializimit për Psikiatri Konsultative ndërlidhëse.



**Valmira Skëndi, PhD,**

Diplomuar në Psikologji Klinike në vitin 2003. Mbron titullin ‘Doktor i Shkencave në Psikologji në vitin 2016. Psikologe klinike që prej vitit 2007, pranë Shërbimit të Psikiatrisë së fëm/adol, QSUT. Pedagoge me kohë të pjesshme prej disa vitesh pranë Fakultetit të Mjekësisë. Eksperiencë punë në fushën e mësimdhënies së psikologjisë në disa fakultete të vendit dhe fushën e parandalimit dhe trainimit në shëndet mendor.

**Psikoterapia në shekullin e XXI: Një qasje biopsikosociale, integrative e kontekstuale.**

V. Skendi; V. Alikaj; E. Dashi;

Profesioni i psikologut në Shqipëri përbën një profesion relativisht të ri, i cili është sa i ri aq edhe i domosdoshëm për shoqërinë tonë. Ndërsa psikoterapia si modalitet trajtimi ka lindur akoma më vonë me Shoqatën Shqiptare të Psikoterapisë…. φ ashtu edhe me aplikues të psikoterapisë të kualifikuar jashtë vendit me kurse 1 ose 2 vjecare.

Psikoterapia merret me trajtimin e psikopatologjike të ndryshme si trajtim i linjës së dytë ose linjës së parë. Psikoterapeuti shpesh është një person (psikolog, psikiatër) që specializohet në psikoterapi. Psikoterapia është quajtur ndryshe edhe kura e shpirtit apo këpërmjet marrëdhënies (Irena Hysenaj “Psikoterapia : Kura e Shpirtit”). Sidoqoftë Psikoterapia në Shqipëri është larg të qënit një kulturë masive (Pango Y., Psikoterapia) ndërsa në botë shumëkush ka psikologun personal, në Shqipëri përbën ende risi të flasësh për psikoterapinë e aq më tepër të ketë një prirje të popullatës për të kërkuar ndihmë terapeutike.

Në ditët e sotme për shëndetin e mendjes ka ende njohje të përcipta në popullatën e thjeshtë. Për më tepër profesioni i terapistit kërkon shumë profesionalizëm, etikë, kohë e një shpirt sfidues e të duruar. Ekzistojnë disa forma të klinikës psikoterapeutike por jo në kuptimin e mirëfillte terapeutike nuk dihet efektiviteti i tyre tek klientët. Të kesh një klinikë psikoterapeutike në Tiranë

është ende një luks. Janë të paktë ata që e njohin vlerën e këshillimin apo psikoterapisë tek një profesionist i kualifikuar për të ofruar këto shërbime.

Psikoterapia merret me trajtimin e psikopatologjike të ndryshme si trajtim i linjës së dytë ose linjës së parë. Psikoterapeuti shpesh është një person (psikolog, psikiatër) që specializohet në psikoterapi. Psikoterapeuti licencohet vetëm nga urdhri i psikoterapeutëve. Psikoterapeuti shpesh është i trajnuar për ushtrimin e psikoterapisë rreth simptomave të rënda dhe atyre neurotike ose psikopatike duke përdorur teknikat e aplikimit të psikologjisë, nga të cilat ajo merr specifikimet e saj në qasjet e ndryshme teorike: Psikoanaliza, Psikoterapia familjare dhe sistemike, Psikoterapia e sjelljes dhe njohjes, Psikoterapia me personin në qendër, Psikoterapia geshtaltiste, Psikoterapia ekzistencialiste, Logoterapia, Psikodrama, Psikoterapia e artit, Psikoterapia e grupit, Analiza bioenergjitike, Analiza transaksionale, Psikoterapia e trupit, Psikoterapia pozitive, Terapia e realitetit, Psikoterapia Integrative, Hipno Psikoterapia (ShShP, 2001).

Ky referim synon të përshkruajë një qasje që ndërthur një sërë disiplinash të ndryshme të cilat mund të bashkëfunksionojnë në shërbim të lehtësimit të pacientëve/klientëve (Wilson, 1998, Siegel, 2019). Ky material thekson rëndësinë e një kuadri evolucionar/bashkëkohor për të kuptuar prirjet për vuajtje mendore dhe sjellje antisociale, dhe se si ato bashkë-ndërthuren në kontekste të ndryshme socio-zhvillimore.

Duke u mbështetur në modelet e mëparshme (Gilbert, 1989, Natyra njerëzore dhe vuajtja, Routledge, Londër, MB; Gilbert, 1995, Clin. Psychol. Psychother., 2, 135; Gilbert, 1998, Br. J. Med. Psychol., 71, 353; Gilbert, 2016, Formulimi i rastit në terapinë e sjelljes njohëse: Trajtimi i rasteve sfiduese, Wiley, Chichester, MB, fq. 50–89) ngrihet domosdoshmëria për një qasje integruese, evolucionare, kontekstuale, biopsikosociale ndaj psikologjisë dhe psikoterapisë.

Megjithëse psikoterapitë janë të fragmentuara për sa i përket shkollave të ndryshme, proceseve të identifikuara dhe ndërhyrjeve, ka gjithashtu thirrje për një qasje shkencore më pluraliste, ndërdisiplinore, integruese dhe konsistente (Gilbert & Kirby, 2019; Wilson, 1998). Kjo nënkupton qasje biopsikosociale, eklektike në funksion të përmbushjes së nevojave të personave me problem psikoemocionale, psikiatrike etj., të cilat mund të shërbejnë si një paltformë shkencore për të ardhmen e psikoterapisë që kanë prirje të jenë në trajtën e mindfulness, relaksimi, meditimi, dhe fokusimi në aspeketet morale të terapisë dhe nevojës për të promovuiar sjellje prosociale dhe etike ndaj vetes dhe të tjerëve.

**Fjalët kyçe:** biopsikosocial, evolutiv, shekulli XXI, qasje integrative, psikoterapi